



Prishtinë: 28.08.2019
Kodi i ZRRE-së: V_1176_1_2019

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_1955_06_19**;
- Ankesa e KESCO-së e datës **22.07.2019**.

në seancën e mbajtur më datë 28.08.2019, nxori këtë:

V E N D I M

- I **REFUZOHET** ankesa e KESCO-së ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin N. B., nga Prishtina, me shifër të konsumatorit DPR 90105692, si e pa bazuar.
- II **MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. **ZRRE/DMK_V_1955_06_19** i datës 19.06.2019.

A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 22.07.2019 ka pranuar ankesën e parashtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së, i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE si vendim i shkalës së parë për këto shkaqe: gjendja e shpenzimit të energjisë elektrike në njehsorin nr.35002720 ka qenë e verifikuar nga KEDS dhe ajo gjendje është evidentuar në procesverbalin e pranimit të lidhjeve të reja të datës 20.08.2015 dhe se gjendja në të dy tarifatat ka qenë zero. Pas kësaj konsumatori Xhevat Babaj me datë 03.08.2016 ka parashtruar kërkesë për lidhje të re dhe se KEDS ka dalur te konsumatori dhe ka vendosur njehsorin elektrik përmes procesverbalit të datës 03.08.2016, por që sipas KEDS është rekomanduar që të mos hapet shifër e re pasi që aty ka ekzistuar një shifër e vjetër dhe se në procesverbalin e datës 23.08.2016 është theksuar se kemi ndërrim njehsori dhe jo lidhje e re. Pra sipas KEDS kërkesa për lidhje të re në objektin ku ka qenë shifra DPR – 90105692 tregon se konsumatori ka tentuar me ik borxhit të energjisë elektrike dhe se dëshmi tjetër është edhe zhdukja e njehsorit elektrik. Në ankesë theksohet se leximet përmes HHU janë të sakta dhe se faturimi i periudhës 08/2015 është i saktë dhe se shpenzimet mbi 10,000 kWh kërkojnë verifikim shtesë. Në ankesë theksohet se gjendja e shpenzimit të energjisë elektrike e njehsorit elektrik e evidentuar në procesverbalin e datës 23.10.2015 tregon se njehsori ka gjendje të shpenzuar dhe nuk mund të bllobohet. Në ankesë theksohet se fakt tjetër se faturimi i muajit 08/2015 është i saktë e dëshmon edhe fakti se humbjet në TS një vit më herë kanë qenë mbi 20%, ndërsa pas faturimit të kWh dhe pas zhdukjes së njehsorit humbjet kanë rënë më pak se 7%. KESCO në ankesën e tyre kanë theksuar se kërkojnë nga Bordi i ZRRE-së që pezullojnë



vendimin e DMK-së ZRRE/DMK_V_1955_06_19 i datës 19.06.2019 për konsumatorin N. B. me shifër DPR – 90105692.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 28.08.2019 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Sa i përket pikës së kundërshtimit të KESCO-s se gjendja e shpenzimit të energjisë elektrike në njehsorin nr.35002720 ka qenë e verifikuar nga KEDS dhe ajo gjendje është evidentuar në procesverbalin e pranimit të lidhjeve të reja të datës 20.08.2015 dhe se gjendja në të dy tarifat ka qenë zero, ZRRE thekson se këtë konstatim e ka dhënë edhe organi i shkallës së parë i ZRRE-së (DMK në ZRRE), pra organi i shkallës së parë në ZRRE ka theksuar se punëtorët e autorizuar në procesverbalin e pranimit të instalimit elektrik të datës 20.08.2015 kanë bërë pranimit të njehsorit elektrik nr.35002720 me gjendje TL=00000 kWh dhe TU=00000 kWh, si dhe është theksuar se njehsori teknikisht është në rregull, si dhe është evidentuar se kemi të bëjmë me kyçje komerciale dhe me Pëlqim Elektroenergjetik (PEE) nr.6534 të datës 14.07.2012. Pra organi i shkallës së parë ka theksuar se vet KEDS në procesverbalin e lartëcekur kanë konstatuar se njehsori elektrik nr.35002720 nuk ka gjendje të shpenzuar të energjisë elektrike, por që pas regjistrimit të konsumatorit në fjalë, me datë 28.08.2015 i ka arritur fatura me shpenzim prej 18,705 kWh apo llogaritur në vlerë financiare prej 1,694.31€ dhe atë si konsumator komercial. Organi i shkallës së parë në ZRRE ka theksuar se punëtorët e autorizuar të KEDS-it për inspektimin e pikave matëse me datë 23.10.2015 gjatë inspektimit të pikës matëse të konsumatorit N. B. kanë evidentuar gjendjen e shpenzimeve të regjistruara në njehsorin elektrik nr.35002720, e cila gjendje në momentin e inspektimit ka qenë është evidentuar TL=010949 kWh dhe TU=007756 kWh, por që njehsori elektrik nuk ka vullë. Pra organi i shkallës së parë i ZRRE në vendimin e saj ka theksuar se në procesverbalin e pranimit nr.077005 të datës 20.08.2015 nuk është evidentuar se njehsori ka gjendje të shpenzuar prej 18,705 kWh, por këtë e ka bërë në procesverbalin e datës 23.10.2015, ndërsa faturimi shpenzimit është bërë me datë 28.08.2015, e që kjo paraqet mospërputhje të vet procesverbaleve të vet KEDS, por që KESCO nuk i ka argumentuar apo arsytuar as në përgjigjen e tyre dhënë konsumatorit e që kjo është në kundërshtim me nenin 10 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë, e që do të duhej të ofrohej sqarim konkret dhe i arsytuar në prova.

Sa i përket pikës tjetër të kundërshtimit të KESCO se nuk i është lejuar konsumatorit Xhevat Babaj të i hapet shifër e re edhe përkundër kërkesës për lidhje të re të datës 03.08.2016 pasi që sipas KEDS aty ka pasur shifër të vjetër andaj kemi ndërrim njehsori, ZRRE thekson se bazuar në shkresat e lëndës, janë vërejtur se mes procesverbaleve të KEDS-it edhe mospërputhje tjera, si në procesverbalin e ndërrimit të njehsorit elektrik nr.0656066 të datës 03.08.2016 theksohet se bëhet ndërrimi i njehsorit elektrik, ku nga matja largohet njehsori nr.35002720 por nuk prezantohet sepse është vjedhur, dhe për matje vendoset njehsori elektrik nr.64692770 me gjendje TL=00000 kWh dhe TU=00000 kWh, e ku ky procesverbal është përpiluar në emër të konsumatorit me shifër DPR – 90105692 në emër të N. B. Ndërsa në procesverbalin e pranimit të instalimit të njehsorit elektrik nr.0109637 të datës 03.08.2016 është bërë pranimit i njehsorit elektrik nr.64692770 me gjendje TL=00000 kWh dhe TU=00000 kWh por që ky procesverbal është përpiluar në emër të Xh. B. Pra, nga kjo shihet se njehsori elektrik nr.64692770 i vendosur te konsumatori N. B. me datë 03.08.2016, ky njehsor është vendosur edhe te konsumatori Xh. B., pra ky njehsor sipas KEDS-it është vendosur edhe te konsumatori N. B. dhe te konsumatori Xh. B. Vlen të theksohet se edhe për këtë mos përputhje KESCO nuk ka dhënë sqarime në përgjigjen e tyre dhenë konsumatorit, e që do të duhej të ofrohej sqarim, si dhe edhe në ankesën e tyre bërë Bordit nuk kanë dhenë asnjë arsytim për këtë mospërputhje, por vetëm kanë deklaruar se konsumatorit Xh. B. i është refuzuar lidhja e re por i



është bërë ndërrimi i njehsorit dhe se konsumatori ka zhdukur njehsorin elektrik pasi janë bërë shpenzimet.

Sa i përket pikës tjetër të kundërshtimit së KESCO se leximet përmes HHU janë të sakta dhe se faturimi i periudhës 08/2015 është i saktë pasi që shpenzimet mbi 10,000 kWh kërkojnë verifikim shtesë, Bordi i ZRRE-së thekson se bazuar në rrjedhën e energjisë elektrike vërehet se nga periudha e regjistrimit të njehsorit elektrik 08/2015 e tutje konsumatori nuk ka shpenzim të faturuar por është faturuar vetëm me taksa fikse, përveç periudhave 09/2016, 08/2017, kur konsumatori është faturuar me shpenzim të energjisë elektrike të shpenzuar. Pra, konsumatori përveç shpenzimit të faturuar për muajin 08/2015 prej 18,705 kWh dhe atë si shpenzim mujor, nuk ka shpenzim tjetër të faturuar e që do të duhej të veçohet dhe për të cilën KESCO do të mund të argumentonte se konsumatori e ka shpenzuar atë shpenzim dhe atë si shpenzim mujor.

Bordi i ZRRE thekson se organi i shkallës së parë i është drejtuar zyrtarisht KEDS dhe KESCO për kompletimin e disa dokumenteve shtesë lidhur me ankesën e konsumatorit, si raportin teknik për pranimin e PEE nr.6534 të datës 14.07.2012, listën e investitorit për regjistrimin e njehsorëve elektrik, të dhëna lidhur me njehsorin elektrik të investitorit për ndërtimin e objektit banesor kolektiv, por që KEDS nuk ka arritur të sigurojë dokumentet e kërkuara nga ZRRE.

Bordi i ZRRE thekson se është i drejtë konstatimi i organit të shkallës së parë të ZRRE se bazuar në shkresat e lëndës se KEDS/KESCO nuk kanë respektuar nenin 28 paragrafin 1 dhe 2 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, ku thuhet se: "1. Furnizuesi është i detyruar të sigurojë që konsumatorët të jenë të faturuar për energjinë e shfrytëzuar dhe për taksat e tjera, në përputhje me llojin e tarifës të dakorduar me Konsumatorin (nëse është e aplikueshme). 2. Faturimi i energjisë së shpenzuar zbatohet për çdo periudhë të faturimit duke u bazuar në të dhënat e lexuara nga njehsori dhe të mbledhura nga Furnizuesi ose Operatori i Sistemit për konsumatorët me tarifa të rregulluara në bazë të tarifave të miratuara nga ZRRE-ja, dhe për konsumatorët e kualifikuar (me çmime të parregulluara) ashtu siç është rënë dakord në kontratën për furnizim". Pra Bordi i ZRRE-së thekson se KEDS/KESCO ka dështuar të argumentojë se shpenzimi i faturuar për muajin 08/2015 prej 18,705 kWh apo llogaritur në vlerë financiare prej 1,694.31 € është bërë nga konsumatori N. B., si dhe nuk ka dhënë asnjë sqarim për mospërputhjet në mes procesverbaleve të vet KEDS-it.

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 28.08.2019 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimet të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Arsim Janova, u.d. kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- KESCO-së, dhe
- Konsumatorit N. B. dhe
- Arkivit të ZRRE-së